



BASHKIA
TIRANË

URDHËR

Nr. 22864, datë 8/6 /2017

“PËR MARRJEN E MASAVE DHE PARANDALIMIN E NDOTJES SË MJEDISIT, NGA INDIVIDË APO SUBJEKTE PRIVATE QË USHTROJNË AKTIVITET TË PALIGJSHËM NË FUSHËN E MBLEDHJES, TRANSPORTIT DHE GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE APO MATERIALEVE TË RICIKLUESHME, QË RREZIKOJNË SHËNDETIN E NJERËZVE”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, shkronja (b), nenit 23, pika 10, nenit 26, nenit 29, pika 4 dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 8, pikat 2 dhe 5 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së Bashkisë dhe të Komunës” i ndryshuar, ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “Për largimin publik të mbeturinave”, vendimit nr. 1, datë 05.02.2007, të Këshillit Bashkiak “Për administrimin e mbetjeve urbane dhe pastrimin e qytetit”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit e jetës së njerëzve,

URDHËROJ:

1. Identifikimin dhe kontrollin nga ana e Policisë Bashkiake të çdo individi apo subjekti privat, që ushtron aktivitetin në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore, në fushën e mbledhjes, transportit dhe grumbullimit të mbeturinave, duke passjellë pasoja në ndotjen e mjedisit urban dhe shëndetit të njerëzve.
2. Policia Bashkiake merr masa të menjëhershme për bllokimin dhe sekuestrimin e materialeve/mbetjeve të riciklueshme që sipas legjislationit në fuqi përbëjnë pasuri shtetërore dhe që janë përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme nga persona fizikë dhe/ose juridikë, të cilët nuk disponojnë dokumentacionin e duhur ligjor të lëshuar nga autoritetet përkatëse.
3. Policia Bashkiake, në përmbushje të detyrave të saj funksionale, mbështet institucionet e tjera shtetërore, kur nga ana e tyre i kërkohet marrja e masave për ndërprerjen e paligjshmërisë ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e mbledhjes, transportit dhe grumbullimit të mbeturinave/materialeve të riciklueshme.
4. Ngarkohet Policia Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme nr. 1 dhe nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Erion VELIAJ

